

STATUTI I SHOQERISE DHE
AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Balkanspro" SH.P.K

Shtetasi:

Alfred Prekaj i lindur me 31.07.1991 ne Bajram curri , me banim ne Tirane identifikuar me ane te Kartes se identitetit J10731129c madhor me zotesi te plote per te vepruar, krijon Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "Balkanspro " SH.P.K , me seli ne Rrugen Kajo Karafili , Pallati nr 15 Hyrja 2,Kati 5.

Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise tregtare "Balkanspro " SH.P.K si dhe Zhvillimi i metejshem i saj.

KREU I

NENI 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

- 1.1 Ortaku i vetem i shoqerise eshte Alfred Prekaj i lindur me 31.07.1991 ne Tirane me banim ne Tirane identifikuar me ane te Kartes se identitetit j10731129c madhor me zotesi te plote per te vepruar, i cili zoterne 100% te kapitalit te shoqerise.

NENI 2

EMERTIMI I SHOQERISE

21. Shoqeria mban enrin "Balkanspro " SH.P.K dhe eshte person juridik shqiptar.

22 Kjo shoqeri e fiton personalitetin e saj juridik me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit .

23 Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin e themelimit dhe statutit, si dhe ne kontratat respektive.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria "Balkanspro"SH.P.K, e ka qendren "Rrugen Kajo Karafili , Pallati nr 15 Hyrja 2,Kati 5.Tirane

dhe gezon te drejten per te hapur dege dhe zyra te perfaqesimit te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.

3.1. Njesite strukturore, deget dhe perfaqesite do te ndertohen konform legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ate te vendeve te tjera ku ajo mund te hape dege.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

4.1. Objekti i Veprimtarise se Shoqerise eshte call center dhe Telemarketing ,

4.2. Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga ortaku i vetem i saj.

4.3. Shoqeria mund te zgjeroje ose kufizoje fushen e veprimtarise se saj ne cdo kohe.

NENI 5

PERGJEGJESIA E ORTAKUT TE VETEM

5.1. Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakut te vetem.

5.2. Ortaku i vetem qe merr pjese ne kete shoqeri, nuk eshte pergjegjes per detyrimet qe linden gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, pertej kapitalit themeltar te saj, qe vete ai ka nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet personale te ortakut te saj.

NENI 6

KOHEZGJATJA

6.1. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj.

NENI 7

SIMBOLET E SHOQERISE

7.1. Shoqeria do te kete vulen e saj "Balkanspro "SH.P.K

KREU II

NENI 8

KAPITALI I SHOQERISE

8. Kapitali i shoqerise "Balkanspro"SH.P.K , eshte 100.000 leke e cili perbehet nga:

- 8.1. Kapitali para me vlere te barabarte me 100.000 (nje qindemije) leke
- 8.2. Kuotat e shoqerise do te ndahen ne nje kuote te vetme,te cilat do te zoterohen 100% nga ortakut i vetem i shoqerise.

1.2 Ortaku i vetem i shoqerise eshte Alfred Prekaj i lindur me 31.07.1991 ne Tirane me banim ne Tirane identifikuar me ane te Kartes se identitetit j10731129c madhor me zotesi te plote per te vepruar, i cili zoterne 3 100% te kapitalit te shoqerise.

8.3. Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

- 9.1. Kapitali themeltar ose pjese te vecanta te tij, jane te transferueshme nga ortaku tek te tretet. Transferimi i kapitalit apo pjeseve te tij nga Ortaku i Vetem ne favor te te treteve, kryhet gjithnje me akt noterial te posacem.
- 9.2. Shoqeria mund te rrisi kapitalin themeltar ose mund ta zvogeloje ate, por gjithnje jo nen kufirin e 100.000 (njeqindeinije) leke. zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit behet me vendim te ortakut te shoqerise dlle sipas parashikimeve te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- 9.3. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenskrimeve dhe pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kerkeses se administratorit.
- 9.4. Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te Ortakut te Vetem ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.
- 9.5. Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet prane Qendres Kombetare te Biznesit per regjistrim nga administratori, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".

NENI 10

TRANSFERIMI I KUOTAVE

10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimnise;
- p) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

10.3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga rasti i kalimit të kuotave, deri në rastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "dhe ndryshimeve të mëvonshme Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

10.4. Kalimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes së tyre nga ortakët e tjerë të shoqërisë.

KREU III NENI

11

ORGANI VENDIMARRËS

11.1. Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

11.2. Ortaku i Vetëm, vendos për shoqërinë si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
- p) mbikeqyjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; d) përfaqesimin e shoqërisë në gjykata dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;

5

- f) ndryshimin e statutit, e selise se shoqerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- g) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise dhe riorganizimin dh e prishjen e shoqerise etj.

11.3. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetem duhet te regjistrohen në regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.4. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

11.5. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 12

ADMINISTRATORI

12.1. Administrator i shoqerise eshte Alfred Prekaj .

12.2. Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte ripertesitje bazuar ne nenin 95/1 te ligjit nr.9901 date

14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Administratori i shoqerise mund te caktohet edhe nje person tjeter, jashta orakeve.

NENI 13

KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

13.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtëzakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vete.

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakut te Vetem.

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligj për Qendrën Kombëtare të Biznesit ;

e) raportojë përpara Ortakut te Vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

13.2. Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

13.3. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve.

13.4. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

NENI 14

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Djetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI15

BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

15.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme, e perbere nga Ortaku i Vetem miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

15.2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e perbere nga Ortaku i vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

NENI 16

MBARIMI I SHOQERISE

16.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themehmin e saj;
- b) rre vendim të Ortakut te Vetem ;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ";
- d) me vendim të gjykatës;

16.2. Ne kete rast, Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim qe parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

16.3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

16.4. Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 17

TRANSFORMIMI I SHOQERISE

17.1. Transformimi i shoqërisë bëhet me vendim të Ortakut të Vetem ose kur ekzistojnë faktore të jashtëm detyrues ligjore, në këto raste vendimi merret pasi është paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë nga ana e administratorit.

17.2. Çdo transformim i bërë në kundërshtim me këto rregulla është i pavlefshëm.

NENI 18

BAZA LIGJORE

18.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këto statute dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

18.2. Për sa nuk parashikohet në këto statute, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.

NENI

MOSMARREVESHJET

19.1. Për mosmarreshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirekuptim.

19.2. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e mosmarreshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane,

NENI 20

DISPOZITA PER FUNDIMTARE

20.1. Ky statut eshte hartuar me vullnetin e lire dhe te plote te Ortakut te Vetem dhe eshte nenshkruar prej tij.

Neni 20

Klauzole mbyltese

20.1 Ky Statut hartohet ne 4 (kater) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKET THEMELUES

"Balkanspro" SH.P.K

01-02-2021

ALFRED PREKAJ

